

BIBLIOTEKA
SHTETIT

8SH-1
K 31

Shefki Karadaku

poezi

UJĘVARĘ

854-1
K 31.

TO NËSHTRU
OLAJU MURATI

Shefki Karadaku

UJËVARË

poezi

33472

SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»

PËR NE, DYZETVJEÇARËT

Për ne, dyzetvjeçarët, koha pati se ç'të thotë,
dyzet vjet në jetën e njeriut janë shumë ...
Socializmi, që na rriti,
diti se ç'të na japë dhe të na kërkojë pastaj;
ne qemë A-ja e revolucionit dhe kënga e të
rënëve,
ne ditëm se ç'të bënim!
Fatet që zgjodhëm u ndanë si degë peme,
fëmijët e gjizës u bënë njerëz me peshë në
pushtet;
dikë e privilegjoj koha për t'u bërë shofer,
dikë e ngriti në piedestalin e shkrirësit, si Korab;
fryma që na mëkoi buka
e thatë me shëllirë dhe kokrra e qepës
u bë fryma e darkave jubilare.
Qepët e fëmijërisë u servirën në pjata gresi,
misri u bë franxhollë.
Për të ndërtuar qytete me apartamente luksoze
më parë ne ndërtuam kasollet e lirisë;

uzinat nisën në thikën e partizanit,
fëmijët në rininë e humbur të Persefonit,
darkat e pasura në çyrekun e ndarë pambarimisht.

Ne kemi se ç'të themi!

B R E G D E T A S E

Diç nga Vlora më mbeti në letër,
hap lirikat e detit të madh,
fryn nga vargu i vjetër Zvérneci,
Kus-Babai buzëqesh si përrallë.

Zgjohen rrugët e qeta të mbrëmjes,
pranë, uji
bankinat rrëmih,
unë vija nga kodrat ushtare
me një grusht Shkumbini në shpirt.

Më gëzonin fytyrat gazmore,
lumturia e tyre e qetë;
ndaj ëndërroja për vjersha madhore
kur lirikat valëzonin si det

Vrisja mendjen për trope të gjera,
kur buzëqeshja e njerëzve s'kish fund,
gjersa kokën e ndieja të rëndë
nga mesnata që derdhej mbi kum.

E mendoja, e ndieja se jeta
më e forta figurë më ish;
sot nga vargu i vjetër fryn era
plot lirika vlonjate në shpirt.

NISJE DREJT SHQIPËRISË

Nga një bisedë shqiptarësh në një aeroport të huaj.

Zhurmon për herë të fundit rok-end-rolli në veshët tanë,

megafoni u zhduk nën avionin që u nis;

ne pak nga pak

të çliruar nga ankthi

qeshëm me gëzim...

Shyqyr, tha një shqiptar,

tani do të vemi te këngët tonë të thjeshta;

më ka marrë malli për kabatë përmetare,

e dini?

BALADA E KOMUNISTIT

Balada e komunistit është e thellë,
balada e tij shkëlqen si zjarr.
Kur erdhi perandori që përtej detit
atë e kérkoi në shi e në acar.

E kérkoi perandori i Romës nëpër qytete
dhe ulériu pastaj se ku fshihej ai
dhe ia kthyen perandorit: ai lufton për njerëzit,
me zemrën e tyre rreh dhe zemra e tij.

E kérkoi perandori në fshatrat e thella
dhe ulériu ai se ku jetonte vallë
dhe ia kthyen perandorit: nëpër këngë kérkoje,
nëpër këngë shkëlqen shpirti i tij i gjallë.

E kérkoi ai nëpër dimrin e tmerrshëm.
Ku ka më të kobshëm se dimri i ngrirë?
Por ia kthyen perandorit: ai në akull endet,
ai në akull ngryset gjersa lufton i lirë.

E kërkoi perandori nëpër arat e mjera
dhe mendoi ai se uria ul çdo kokë,
por ia kthyen perandorit: ai ha bukë egjëre
dhe si dielli mëkon me dashuri këtë tokë.

Ku është ai atëherë, perandori klithi,
që ta nis të lidhur si skllav në Romë?
Dhe ia kthyen perandorit: na këto batare trimi
dhe nisu çalë-çalë në qivur si kufomë!

M A R G A R I T A

E thërrisin Margaritë. Nuk ishte
Margarita e «Faustit», por e nënës së saj;
në lagjet plot lot të Beratit njozu diellin,
flokët e tij u bënë flokët e saj të bukur;
në sy i pati yjet dhe këngët në gojë.
...e thërresim Margaritë...

E thërrisin Margaritë. Nuk ishte
Margarita e «Faustit», por e atdheut të saj;
i donte shtëpitë të bardha, njerëzit të qeshur,
çamarrokët me lule. Dhe për këtë një ditë
e kapën fashistët dhe e futën në qeli.
...e thërresim Margaritë...

E thërrisin Margaritë. Nuk ishte
Margarita e «Faustit», por e Partisë së saj;
e donte atdheun të bukur me diell mbi grurë,
qytetet të lumtura dhe punëtorët liriplotë
dhe për këtë fashistët i dhanë një plumb të zi.
...e thërresim Margaritë...

E thërrisin Margaritë. Nuk ishte
Margarita e «Faustit», por e lirisë së saj;
kur fitoren e bëmë të bardhë dhe krah i dhamë
i thamë së toku: Eja, Margaritë!
Tani jemi në diell. Dhé ajo ndodhet mes nesh.
...e thërresim Margaritë...

FËMIJËRIA

Unë e di si vjen fëmijëria dhe troket në derë
trak-truk,

jam fëmijëria me lule kumbullash diku,
jam fëmijëria që vij nga shtegtime të largëta
dhe në këtë derë poeti trokas pa zor,
unë vij nga qyteti i vjetër me qerpiç,
nga rrugët fëmijnore me gurë,
me zëra kalimtarësh në muzgun vjeshtor.

Unë vij nga kalldrëmi i vjetër i etërve,
nga kinemaja me filmat pa zë,
nga shkolla pa xama,
unë vij këmbëzbathur,
trak-trak, trak-trak!

Trokas te kjo derë si te dera ime
dhe s'më mbetet jo, hatri që u rrite,
më harrove,
u bëre burrë.

NATË PRILLI

Ranë të flenë
njerëzit në pallate,
vetëm prilli
në qytet bredh
dhe më prish gjumin,
herë me ardhje
patash,
herë me taksinë
e nuses me vel.
Me duart e tij,
të dashuruara me
jetën,
ai troket si fëmijët
në xham:
Ngrihuni, njerëz!
Ngrihuni, njerëz,
të shikoni qytetin
me këmishë
jargavan.

TORTA

Ai mendon: djali i tij mbush sonte
trembëdhjetë vjeç nga jet' e thjeshtë,
pas, në sedilje i kujtohet torta,
rëndon mbi të si pisha plot me fletë.

Taksia ikën. Burri vështron orën:
me siguri djali përgjumur rri
dhe pret ai babanë, festën, tortën
gjersa përmbi divan gjumi e pi.

Ai si nëpër gjumë vështron mes xhamesh.
Një grua hipën qetë në taksi,

shoferi sheh: ajo po bëhet nënë,
ajo e lodhur pranë tortës rri.

Ajo për herë të parë pret të lindë
e buza pak i dridhet, s'di ç'të thotë;
befas shoferi qesh, ndalet një çikë
e tortën hap si një baba i ngrohtë.

334++

Shqipëri është e veshur me
dritë e lindjeve qëndrore e që
mosha e tij me qindra vite matet,

RRAPI I BEZISTANIT

Mosha e tij me qindra vite matet,
s'e di kush e ka mbjellë në Bezistan,
mbase dikur

Gjergji pas súlmesh natën,
mbase dikush nga llauzi nomad.

Po aty hasmi varte dita-ditës
heronj, komitë,

trima dhe azganë;
armiqtë qeshnin, vuarin therorët
dhe rrapi kishte mund, dhimbje, duman.

Pastaj liria erdhi; gjithë taboret
shkuan drejt detit copë-çikë,
atëherë vjeshtë qe, të zhvishej s'donte,
harlisej, qeshte rrapi gjethedritë.

Gjersa e veshën me mermer mes sheshit,
stola i vumë rravit tonë të mirë
ai, simbol i kujeve,
buzëqeshi,
dhe veç atëherë mori frymë i lirë.

Shikonte sheshin, ndiente vrap urbanësh,
pallatet e mbulonin gjer në grivë,
taksitë poshtë gjethesh prisnin dasmë
e qulleshin si vajzat nëpër shi.

Plak i stërlashtë rrinte, qeshte, prehej,
qyteti im modern i shtonte mall,
veç mbrëmjeve, si ca mirazhe detesh,
ndiente si hije
nomadet kohëra prapë.

MË KUJTOHEN PUNËTORËT E PARË...

Më kujtohen punëtorët e parë
që nisën mëngjesin e Republikës me sy
mëngjesi me dritë qe.

Çfarë kish në mëngjes?
Shina dhe ëndërrime industriale.
Fërshëlljen trenat e gjatë në ëndrrat e tyre,
— fërshëllimë industriale e qetë. —

Më kujtohen punëtorët e parë ...

Më kujtohen punëtorët e parë,
më kujtohen duart e tyre që ngritën themelët e
Republikës,

themelët të thella qenë.

Çfarë kish në themelë?

Diell dhe hekur të fortë.

Planet e kundërrevolucionit të qullura me shira
qenë.

Kështu u ngrit Republika,
themelet më të thella se Adriatiku u bënë!
Kalo përpara, shok!
- Jetojmë të sigurt në themele të forta.

Më kujtohen punëtorët e parë . . .

DREJT DUMRESĒ

Gjithë Dumrenë shëtisja atëherë
kënd më kënd në kodra me grurë,
në Dragot më ftonte hareja,
klarineta më mblidhte në Gurrë.

Tok' e lëashtë liqenesh të kaltër,
ç'je e bukur në majin e ngrohtë!
Nga Samiu vjen vargu me patë
dhe të sjell mesazhe jugorë.

Shoh Dumrenë: rrafshultat me grurë, fshatra, pyje dhe rrugë përqark ... Si kuaj me jele të butë hanë drithë kombajnat në Prat.

Qeshin vajzat e mira me dhele
dhe çapkënçe shohin sërish;
gaz i madh ta shohësh Seferajn
nga makina që bluan kallinj.

Gaz i madh ta shohësh Dumrenë
gjithë natën të qeshë në arë;
drejt Samiut ik pata e vjetër
me mesazhe kalliri në krah.

PLAZHI NË DIMËR

Plazhi në dimër është i padurueshëm,
ashtu siç është
një vend i shkretë;
deti që gjithë verën
me njerëzit
është gëzuar,
thinjet tani
përkokësisht si pleqtë.

NATË GUSHTI

Natë gushti, ja era më vrunduj
përmbi rrugë ngrë perdet me shi
s'flë qyteti, por ujin i lumtur
e vështron, e thith si fëmijë.

s'flë qyteti, por ujin i lumtur
nën vetura kërcasin plluq-plluq;
si udhëtare e lodhur nga vapa
edhe vera shtegtoi në jug.

Dhe, pas vapës së fortë të ditës

edhe ajrit të djegur si eshkë,

erdhi vjeshta me shira papritur,
fitimtare zbraz shira nga retë.

Nëpër qoshe rrugësh e sheshesh

strukën çiftet me mallin në gji,

veç ata s'mérziten që retë

nuk mbarojnë së qari me shi.

NA THANË DIKUR ARMİQTË...

Ç'e doni socializmin? — na thanë dikur armiqtë.
Eshtë sofër bosh, e zbrazur, si verë pa shi dhe bukë!
Po shkuan dyzet vjet, socializmi ecën madhërisht,
u shtruan dyzet sofa gjigante me plot të mira;
vetëm ata urejtjen e shpirtit s'e shuajtën kurrë.

Ç'e doni socializmin? — na thanë dikur armiqtë.
Pa dasma, pa gëzim si natë në pyllin me drurë!
Dhe shkuan dyzet vjet, socializmi ecën madhërisht,
u bënë mijëra dasma, gëzimi mbushi lirinë;
vetëm ata natën e shpirtit s'e shuajtën kurrë.

Ç'e doni socializmin? — na thanë dikur armiqtë.
Pa shpresa, pa të nesërme si fushë pa lule, pemë!
Po shkuan dyzet vjet, socializmi ecën madhërisht,
u mboll e mbiu e ardhmja si lulja në lëndinë;
vetëm ata urejtjen e shpirtit s'e shuajtën kurrë.

VLORA NATËN

Përmes ullishtës së Panajës
një çast e artë u duke ti,
makina ikte prapa natës,
ç'e kishe vallë aq hijeshi.

C'ishte ai shkëlqim i bukur
nga Toponaja në Sturos?
Gjerdan i brishtë plot neone
shkëlqente madhërisht përposh.

Aty-këtu në këtë pamje
valëzonte deti në Koretë;
e flinte, qeshte, zgjohej prapë
Vlora e bukur cipëdet.

M J E L È S E T

Në agsholin e qetë të verës,
kur yjet janë djegur si neonë,
me duar stërpikur me qumësht
mjelëset pas kopesë fugojnë.

Bulërojnë lopët e buta,
nga qumështi rëndoijnë «Xhersejt»,
dhe ato, punëtoret, të urtat,
qytetet me qumësht ushqejnë.

Por ato, të thjeshtat, të butat,
mendojnë mëngjesesh për ne,
kur dimri rëndon pishat e blerta,
shqetësohen për çerdhet atje.

Kur dimri ulerin nëpër rrugë
dhe në dyqan baballarët shkojnë,
ato i gjen prapë të urta
pas qumështit të bardhë në bidonë.

F I S H E K Z J A R R E T

Mbrëmje e bukur,
bulevarde festivë,
fishekzjarret
mbi kokën time
ylberin e shiut vijëzojnë.
Mendoj se deri tek kjo natë
poetike
u deshën qindra
netë të ashpra;
baruti i predhave,
më parë se gëzimi i fishekzjarreve,
zgjoi fëmijërinë tonë.

P R E S P A

Mbi Zvezdë shket rruga gri e Prespës,
Diellasi përbri liqenit zbardh;
është vjeshtë dhe pyjet janë shkundur
veç mollët në Goricë laroshen prapë.

Kërcejnë pleqtë në dasma buzë liqenit
e burrat darkën presin për festim
e kanë qejf që vajzat shpirtpëllumbi
jeta i merr si vjeshtën, fluturim.

Ja, tej në Zvezdë i ngrirë nga mandatat
guri i kurbetçinjve¹⁾ rri i trishtë;
ajo rrugë mërgimesh mbeti prapa
dhe tash nga dasmat ikën tinëzisht.

Ai akoma qan me këngë dhembjesh
ndërsa duvaku i nuses zbardh si atje,
sikur me brymë të bardhë Prespe të ishte,
sikur argjend' i vjeshtës
ta kish sjellë.

1) Guri i kurbetçinjve gjendet në Qafën e Zvezdës.

DREJT GRYKËS SË TAMARES

Kelmendi mes shkrepash bënte sogje
i lagur nga ninullat e tua, Selcë,
më tej Lëpushës, lugut të Vermoshit,
akoma dimri varej nëpër degë.

Dhe ende nëpër kullat veriore
dëbora e bardhë ishte ende e ngrirë
megjithëse prilli dyndej orë pas ore
dhe flladi i mermë ndihej në hapësirë.

Mbi shkëmb të Mkushit mbiu bari
kurse nën të koshadhe armiqsh flenë.
Qe viti 1942, dufi malësor
në hon gremiste feste, gjysmëhënë.

Tani kelmendasit i gjen në valle,
në Gjirokastër në tetor i gjen,
prandaj zbresin të qeshur e të lumtur
me lahutarët e tyre epikëmëdhenj.

ÇADRÀ

Ata iknin të dy nën një çadër,
ai ishte mësues në fshat,
ajo mjelëse. Bintë shi me erë
dhe rruga qe mbushur me baltë.

E shiu binte pareshtur,
dhe vajza e ndiente në mish,
kurse djali përpara vraponte
për t'ia lënë çadrën plotësisht.

Por ajo buzëqeshte e lumtur
dhe e linte djaloshin nën të,
gjersa mbetën të dy krejt të qullur,
veç çadrën e mbanin gjithnjë.

PLAZHISTËT E NATES

Po, plazhi është vërtet i bukur kur ka njerëz,
kabina e orkestra në sallat e ndezur madhërisht.
Dhe ne të dy jemi pjesë e të gjithëve
dhe njëkohësisht të vetmit
që ditën verojmë nën çadra si të gjithë
ndërsa natën hapim çadrën e hënës
si të vetmen.
që fsheh plazhisten e natës:
dashurinë.

MBRËMJE DIMRI NË POJAN

Ja dhe qerret e fundit hynë
nëpër fshatin fushor Pojan,
qerrtarët — si të veshur me brymë
prej gëzofit të dimrit shafran.

Ecin qetë shtruar mës ngricës,
këngës dikush nga burrat ia thotë;
fryn nga qafa Zvezdës borica
dhe argjendin ia derdh përmbi flokë.

Ah, boricë, boricë thinjoshe
ç'e mbulove Pojanin si trill!
Tymojnë rëndë qerrtarët e fortë,
poshtë bërrucash të ngrohta si prill.

Qetë ndalen. Qerrtarët e lodhur
kukurizma e klubit i mbledh.
Ah, boricë, boricë cipëftohur,
shpirtin, moj dimrake, ç'ma deh!

KËNDESİ

Humbi në terr këndesi klasik i agut,
si e vëtmja orë astronomike që ish,
humbi në terr dhe gardhi
i kasolles klasike.
Tani në qytet tringëlljinë katër orë gëzueshëm,
tani në qytet këndojnë pesë lokomotiva,
tani në qytet njëqind urbanë gumëzhijnë.
Ah, këndes i vogël i fëmijërisë,
ki, ki këndon mbi gjerdhe,
po gjerdhet kanë dyzet vjet që janë bërë hi,
vetëm ti këndon mbi to, ki, ki.

BLLOKU «VASIL SHANTO»

Le të ndërtojë bota kulla të rënda
dhe le të ketë Bruklini qieSSHPUES
ky bllok i ri pallatesh gjithë gëzimet
i mblodhi për një çast në këtë ditë të bukur.

Qyteti ynë vazhdon të rritet tutje,
ky bllok mbetet më i riu, natyrish,
hyjnë në të ata që bëjnë plugje,
ata që derdhin bukën e çeliktë.

Ata që janë nderi, pranvera
e jetës së Tiranës si agim,
në darka vonë, nëpër dritare era
bisedat mbledh nga nata fluturim.

Ata nuk dinë si ta shprehin dufin,
harenë që i mbush me art të madh;
gjersa kapiten, shuajnë abazhurin,
gjersa pallatet nata fut ndër krahë.

Gjersa qetësohen festat, darkat, punët
e blloku «Vasil Shanto» fle i qetë.
Ndërsa Bruklinin atje e çajnë hajdutët,
ndërsa Bruklinin tani e mbysin retë.

Z V È R N E C

Tutje bajamet u dukën,
në Zvérnec ato rriten shumë,
dielli varej mbi shalqinjtë e mbledhur
ndërsa deti digjej mbi shkumë.

Unë e ndieja se ti nga dielli
ishe bërë atë çast si prush
edhe flokët e derdhur si elbi
binin erë zhumbriçë dhe rrush.

Unë e dija se ti nëpër fushë
thithje erën e detit të madh
që nën Nartë harbonte merlucët
mes lagunës së bardhë si llak.

Unë e ndieja që ti nëpër ara
mirrje erën e ftoit të mirë.
Rrinim të heshtur, dremiste Panaja,
disku i diellit qeshte i shkrirë.

Hanim rrush. Dhe ti pa më thënë
nga bistaku më lije diçka,
sikur ndjenjat që s'dinim t'i shprehnim
ato kokrra i fshihnin si mjaltë.

Agjensitë e lajmeve dhanë lajmin
e vdekjes së shahut.

Varrin ia bënë në Luksor, atje ku faraonët flenë.
Unë nuk habitem,
mumjet mbretërore
atje e kanë vendin,
mumjet arkaike
të shekullit XX.
Revolucionet do t'i fshijnë ato
dhe tek mumja e faraonit Tutmes¹⁾
do t'i vënë!

1) Tutmes, — faraon egjiptian

FUSTANELLA

Unë jam përkulur para lapidarëve të bardhë,
por edhe para teje, fustanellë, jam përkulur në
sepse më kujton kohërat e vjetra me pallë,
dhe tymin e luftës që ngrihej në re.

Sepse të ka veshur ty dikur Gjoleka
dhë Çercizi të ka veshur në luftë;
nëpër palat e bardha baruti është përdhuron
dhe agimi me një dritë të purpurt.

Ndaj tani në palat e tuastë bardhasq është
epika e betejave ndihet madhërisht,
herë nëpër ditët tonë tund jataganët,
herë pushkët zbraz e mbush sérish.

N D O D H I

Ecën ngadalë një mushkë mes qytetit
ndërsa makinat përreth shkasin veri,
dikush nga djemtë që bredhin trotuarit
habitët, qesh ha-ha e hi-hi-hi!

Fshatari ecën i heshtur para mushkës
e mendjen tëj në fshat e ka,
befas e ndien se diç nuk shkon mes udhës,
ndalon i qetë e kthehet nga ata.

Kthehet, vështron e tund kokën;
të rrinë pa punë këta djem në këtë orë?
Dikush cigare thith e qesh me të madhe,
dikush me mushkën zë e bën humor.

Të gjithë burra, të gjithë të lumtur janë,
të veshur me kostume si në festë,
mbase të mirë i kanë baballarët,
mendon fshatari zemërthjeshtë.

Mbase kanë luftuar dhe në Gribckë,
mbase me ta çapën e bukës ndamë;
por ja, fëmijët e tyre kot rrinë,
qeshin me mua e pinë.

Ai afrohet dhe u thotë dy fjalë,
ngadalë, zemërmadh, sinqerisht:
«Kjo mushkë mbase babanë tënd, djalë,
e mbajti nga Borova në Bilisht!

Kjo mushkë i ka zbritur që nga malet
më parë se të kenë automobilë.
Kështu, djema, tani nga unë të fala
m'i bëni baballarëve të mirë!»

Dhe rish ai nxiton përmes asfaltit
e mendjen tej në fshat gjithnjë e mban.
Ndërsa makinat si veriu shkasin,
ai mushkës grivë sytë s'ia ndan.

LIRIKË MBRËMJESH

Kam rënë në mendime ndërsa nata
e butë ndehet mbi kryeqytet,
fjalosen në park, diku, në një grup lajthatash
e një ekran televiziv shkëlqen.

E qetë rruga tutje natës shtrihet,
gjersa nën dritat e neonit humb;
mendoj: sa njerëz porsi unë enden
mes mbrëmjes qytetare gushëpëllumb.

Mendoj: sa njerëz porsi unë jetën
e ndiejnë në çdo ind si një poezi,
mbase ata janë farefis poetësh,
mbase lirika thurin në qetësi.

VRASJA E PARTIZANIT TË PANJOHUR

1

Asnjeri s'e njihte djaloshin e bukur,
sepse veç një natë qëndroi me ta
dhe tok me të tjerët luftoi në male,
sado që si trim një ditë u vra.

Ra partizani. Edhe pse kërkuan
s'i gjetën me vete asgjë si njoftim,
ai kishte zbritur nga jugu i largët
dhe natën s'kish thënë as emrin e tij.

Ai s'kishte thënë se ç'nënë e priste,
se cila brigadë e priste atje.
Dhe ja, atë ditë Kukuta e shihte
të shtrirë si lis në tokën e vet.

Tani mbi mermer u ngjall heroi
 që erdhi nga larg dhe mbeti në pyll.
 Dhe s'dinte njeri në fshat ç'kérkonte
 dhe s'dinte njeri ku shkonte ky yll.

Qëndroi skulptori me ditë dhe net,
 mbi sytë dhe ballin e trimit pastaj,
 krijoi bustinën dhe zemrën e nxeh të,
 krijoi belgjikun që mbante në krah.

Se trimi kish zëra nga gjithë atdheu,
 nga fshati dhe malet e largët të tij,
 megjithëse e dinin se vinte nga jugu
 ku qeshte Kukuta me bredha të rinj.

GJITHMONË PLOT ZHURMË

Gjithmonë plot zhurmëjeta do të ecë,
heshtjen e trishtë do ta përbuzë.
Kur bredh me gaz në vendin tim të shtronjtë
vallet kérkoj nëpër katund.

Në mbrëmje kur fryn era në shelgjishte
nën tisin hënëzor në valle dal
ku qeshin vajzat kooperativiste
dhe nusja me fustanin gri në all.

I lumtur midis tyre zë e endem,
nga kjo hare nuk ndiej mërzi,
sepse zien gjaku im, se këngët trishtë
i mbyti jeta plot gëzim të ri.

ELEKTRIFIKIM

Natë. Ajo është një shembull i këtij faza që
Fshati Harpun ka rënë në mendime; qytetarët
në qendrën e kooperativës së emri të cilat nuk
ndihen këngë.

Para se të ndizen konstelacionet në qilli,
në ndizen rrëth nesh
Ha do llampat gjithkund.
Dikush i lumtur thotë:
Partisë, para se të bënte elektrifikimin e fshatit
qyteteve, buzinave, i është dashur
të bëjë elektrifikimin e mendimeve
gjer në
elektrifikimin e fshatit Harpun.

KTHIMI NË FSHAT

Briri i hënës ra në pellg
mes plepave të zhytur në koritë,
po vij në fshatin ku lumi ndjek
këmbët e gjata të rakitës¹⁾.

Në zemrën time malli sot peshon
me qindra èndrra e mendime,
mes gjerdheve që ende s'po i shoh
nën dritën qumështore të shelgjishtes.

Ku jeni ju, rakita të vegjëlisë,
ku pendët e pëllumbabit mbetnin shpesh,
dhe ku nër harkun e qiellit të dlirtë
korija fletëbutë gjithmonë hësht?

Èshtë shembur gardhi im i vjetër,
mbi të ka shkuar një traktor i rëndë,
është mbjellë toka me grurë e pjepër,
i trishtë plepi vetëm hesht në këmbë.

1) rakitë — shkurre që rritet buzë lumenjve

Bukur! Sotjeta ecën aq gazmore,
asgjë s'mbaron tek guri si portik
sepse kam njerëzit që m'i hapin portat,
kam vallet plot gëzim fshatar jetik.

Pranomëni ju, kooperativistë,
të vij tek këndi i dashur shpesh,
sepse këtu me mall kujtoj koriten
ku brir' i hënës plepat tanë ndez.

NETËT E JUGUT

Netët e jugut kanë muzg të kaltër,
netët e jugut kanë diç të artë,
nën rrrobën e limonave të heshtur
diçka më the për zemrën që ka mall.

Diçka më the për puñën dhe tarracat
ku sot njeriu shkon këmbësigurtë,
ndërton qytete, ka zemër të madhe
si vjeshta e Lukovës faqehurmë.

Ti ende pranë meje rri mbërthyer
nga shpirt i rivierës dhe ngadalë
kokën ma vë në supe menduar
me të natyrshmen dashuri të zjarrtë,

POEMA

KASKADAT

Ky është lijeni me tri kate,
me tri diga
si tre male kreshtëfortë.

Ai ka tre emra:

Dejë,

Koman,

Fierzë,

pas tri dekadash

mbushur me Drin ujëplotë.

Për t'i mbushur lijenet

u deshën vite

ndërsa natyrës

miliona vjet.

Arsyeja punëtore

më e thella, më e larta

evolucionin e natyrës

arkaik e nxjerr.

Të mbështetur

në katet ujorë të kaskadës

tre vellezër kuvendojnë,
geshin miqësish, me zërin elektrik
telejtajpi i kabllove
më shpejt se me mors
vazhdimish i lidh.
E ikën ky zë
rrugëve të largëta
mbi shtylla tensioni
vrapon, vrapon,
në Fier ndez sytë
e brishtë të neonit,
në Korçë
makinën e tezgjahut zgjon.
Në Kukës
teletajpi
ajror i vellezërve
nëpër grykën e radios futet
për një çast
dhe nga larg,
në rrugët
e pambaruara të jetës,
spikerin e zbrit
si me parashutë në fshat.
E në gjuhën e rëndë të
kabllove të gjata
mesazhet e tyre
në të katër anët venë,

herë
nëpër shiun
e rrëmbyer të janareve,
herë, nëpër zhegun
e verës.

Kush i pa kaskadat
e gjata
të liqeneve
dhe me forcën punëtore vallë
s'u habit?
Tri diga u ngritën
në tri gryka
malore,
tri dekada
Drini
u mbush madhërisht.
E përplasej lumi
dimrave të potershëm
në gjokset punëtore
si në shkëmbinj të sertë...

Dimri i bardhë
me acarin dhe erën

sulmonte

durimin e tyre

të madh,

por pastaj têrhiqej,
ulérinte,

ndrydhej

e nuk mundi ta mposhtë

marshimin aspak.

Piramidat

kanë vlerë

historike

dihet,

por digat

s'kanë vlerë

të thjeshtë relikesh . . .

Por digat

nuk janë teka faraonësh

ose përmendore

të kultit antik,

janë ura të mëdha për të lidhur

kohët

e të lumturve

që horizonti

shqiptar rrit.

Pas digave

uji,

pas ujit,

kaskadat,

turbinat
vrundullojné
në këtë
sulm me shi.

Dita kur u mbushën
grykat lumore
kanë qenë ditë të papara
mbi dhé,

fshatrat epikë
këtë fushë
ujore

u shpërngulën
si mbi rrota madhërisht

më tej.

E më të bukura
zbardhën
më tutje kullat,
shkallët,
rrugët,
sheshet.

Dhe me poemën
e pambaruar elektrike

(si thekët e nuses —

linjat mbi kokë)

lavdinë shqiptare

më lart do ta shpien,
përjetësisht

krahët e tyre

të fortë.

M E T A L U R G È T

Mëngjeseve,
kur rrugët zbulon dielli
dhe qyteti industrial
nga `jeta qesh,

me ëndrra rino
urbanët përcjellin
ata, metalurgët e viganit

Bradashesh.

Ata, të fortët,
që nuk u lodhën kurrë,
që kohën e masin me punë
dhe metal.

Herkula,

që Pishkashin mbajnë mbi supe
si të mbanin
malin gushëbardhë

Muçal.

Farkëtarëve
të ditëve tonë të mira
lava e zjarrtë
si ylber u rrjedh,

kur këndon në Bradashesh

Ohri lirika

dhe Çervenaka

metalin

e rëndë derdh.

Këndon nën ta

inetali i ashpër,

si të këndonte

një këngëtar i mirë.

Ja, shkrihen

shkëmbenjtë

e Pishkashit të ashpër,

për t'u bërë më vonë pér traktorët

zinxhirë.

Dhe kthehet

nga muskujt e tyre hekuri

në shtylla tensioni,

traktorë shqiptarë.

Kjo mbetet

lavdia e tyre e madhe sa dheu

ku ecin të lumtur

mijëra farkëtarë.

Kjo është

kënga pér punën,

më e forta

nga të gjitha këngët

e të lashtit Hefest . . .

Ditë pune e zakonshme.
Në Bradashesh dielli
nga mali Munellë
ngrihet si div;
qyteti metalurg
me hënë i pështjellë
ngre jorganin e natës
me muskujt çelik.
E zgjohen rrugët
e reja të njerëzve,
zgjohen dhe zogjtë
e bukur në park,
lulet në tokë
u ngajnjë
mëngjeseve...
Ditë pune e thjeshtë,
ditë pune e gëzuar.
Nga meraku i planit
punëtori baret,
kalon gjokszjarrtë
me sytë mbi furra,
kalon dhe më tutje
si era
që rend.
Kalon dhe më tutje vagoni
i ngarkuar nga hekuri,

nga djersa e tyre.

Ja, këta

janë shkrirësit,

njerëz të fortë,

si ne;

gjak punëtori

kanë;

dikë në mbrëmje

e ledhatojnë fëmijët,

dikush hap librat,

si rrugën e paanë.

Dikush

mendon për botën që përleshet,
për Libanin,

Afrikën e Jugut . . .

Mendon për revolucionin,
popujt,

përleshjet,

për lutëra

proletarësh

dhëmb për dhëmb,

gjersa qepallat

ia ul gjumi i ëmbël . . .

Gjersa

në dritaren e madhe të pallatit

vjen dhe rri

hëna e plotë

e u bën bisedë

shkrirësve të malit,

atyre

që çajnë

blokada me gjoks të fortë.

Atyre

që krenarë i rrjnjë,

kohës që ecën

dhe parakalojnë

çdo 1 Maj

me fitore në gji

dhe i thonë Partisë:

Ne,

metalurgët, stafetën

e revolucionit

e çojmë tutje shekujve

gjithnjë .

PËRMBAJTJA

VJERSHA

Për ne, dyzetvjeçarët	5
Bregdetase	7
Nisje drejt Shqipërisë	9
Balada e komunistit	10
Margarita	12
Fëmijëria	14
Natë prilli	15
Torta	16
Rrapi i Bezistanit	18
Më kujtohen punëtorët e parë ...	20
Drejt Dumresë	22
Plazhi në dimër	24
Natë gushti	25
Na thanë dikur armiqtë ...	26
Vlora natën	27
Mjelëset	28
Fishekzjarret	29
Prespa	30
Drejt grykës së Tamarës	31
Çadra	32
Plazhistët e natës	33
Mbrëmje dimri në Pojan	34
Këndesi	35
Blloku «Vasil Shanto»	36
Zvérnec	38
Faraonët e shekullit XX	40

Fustanella	41
Ndodhi	42
Lirikë mbrëmjesh	44
Vrasja e partizanit të panjohur	45
Gjithmonë plot zhurmë	47
Elektrifikim	48
Kthimi në fshat	49
Netët e Jugut	51

POEMA

Kaskadat	55
Metalurgët	61

Karadaku, Sh.

Ujëvarë. Poezi. [Red.: S. Dajo]. T,
«Naim Frashëri», 1985,

68 f.

(B.m.) dhe

(B.v.): 891.983-1

K 31

Tirazhi 1500 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-81

KOMBINATI POLIGRAFIK Shtypshkronja e Re
Tiranë. 1985